



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Prilbjenos/Prilbato Received/Deliverty	15.06.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ zjedmtca Org./Unit	Hi. Prot Hi. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMORAK	3495/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.592/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2102/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 08.06.2022 ka shqyrtuar ankesën A.nr.592/2021 të datës 25.06.2021, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted]

kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.592/2021 të datës 25.06.2021, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës së Jugut me datë 24.02.2021 shpall konkursin me numër 07-111/01-0013465/21 për pozitën vendin e punës " Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "A.Z.Çajupi" në Mitrovicë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja [redacted] Ankuesja

e pa kënaqur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për vendin e punës punës " Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "A.Z.Çajupi" në Mitrovicë, me datë 25.05.2021 parashtron ankesën me numër 01-111/01-0038572/21 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës me datë 04.06.2021 merr Vendimin me numër 01-111/01-0038572-4/21 me të cilin vendim ankueses i refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe e len në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm me nr.07-111/01-0036123/21 i datës 17.05.2021 të Kryesuesit të Komisionit për zgjedhjen e drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues dhe e këshillon palën që nëse është i pa kënaqur me këtë vendim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente.

Ankuesja [redacted] e pa kënaqur me Vendimin e datës 04.06.2021 me numër 01-111/01-0038572-4/21 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës, me datë 25.06.2021 parashtron ankesën me numër të protokollit 3306/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli më datë 09.08.2021 përmes shkresës me numër të protokollit 4149/2020, ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 25.06.2021 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 08.06.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2102/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses [redacted] ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së e datës 09.08.2021 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 25.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 25.06.2021 me numër protokollit 3306/2021e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 17.05.2021; Kopja e konkursit i datës 24.02.2021 me numër 07-111/01-0013465/21 për pozitën vendin e punës " Drejtor në Shkollën Fillore të Mesme të Ultë "A.Z.Çajupi" në Mitrovicë; Ankesa e datës 25.05.202 me numër 01-111/01-0038572/21 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës; Vendimi i datës 04.06.2021 me numër 01-111/01-0038572-4/21 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës; Rekomandimi i Komisionit intervistues; Deklarata për betim e datës 06.04.2021; Foto për [redacted] në takime me Nismën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses [redacted] sepse:

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e shpallur me datë 24.02.2021 me numër 07-111/01-0013465/21 për pozitën vendin e punës " Drejtor në Shkollën Fillore të Mesme të Ultë "A.Z.Çajupi" në Mitrovicë, andaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 2 paragrafit 4 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*, respektivisht në këtë kuptim, Kolegji ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit



të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike në fushën e arsimit, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesja tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.592/2021 të datës 25.06.2021, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

Pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, Kolegji udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente*".

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr. 592/2021; datë 15.06.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.